Përderisa hyjmë në epokën digjitale, në të cilën hapësira virtuale dhe reale do të determinoj në mënyrë të barabartë zhvillimin e jetës shkencore kulturore dhe sociale te njeriut, Asociacioni për Softuer të Lirë dhe të Hapur (ASLH; The Association for Free and Open Softëare) ka qëllimin afatgjate të ngris dhe punoj në çështjet që kjo (epoka digjitale) do të paraqes.

Puna direkte eshtë promovimi bujar I Programeve me kod të hapur dhe Diturisë, si dhe krijimi dhe propagandimi për pasje kujdes ndaj ëështjeve që kanë lidhje sociale dhe filozofike.

Misioni i më tejmë i ASLH është të forcoj dhe angazhoj njerëzit nga mbarë bota që të mbledhin dhe zhvillojnë përmbajtje edukative me licencë gratis ose në domenin publik, dhe të shpërndajnë atë globalisht dhe me efekt. ASLH do të siguroj infrastrukturën themelore dhe strukturën organizative për përkrahjen dhe zhvillimin e diturisë së hapur dhe projekteve softuerike si dhe përpjekjeve tjera të cilat i shërbejnë këtij misioni. ASLH do t'i vendos dhe mbaj informatat e nevojshme nga projektet e saja në internet pa pagesë dhe vazhdimisht.

Që të krijoj beneficionet më të mira për popullatën e Kosovës, ASLH do t'i bashkoj forcat me përkrahësit tjerë të të njëjtës kauzë. Në vend se të krijojmë shumë organizata në Kosovë ne i ftojmë organizatat tjera ndërkombëtare që t'i bashkojnë forcat me ne, në formë të punës në grupe brenda ASLH që të implementojmë objektivat tona në republikën e vogël.

Emri dhe Mbiemri

Emaili

Nr. Telefonit

Kompania

Interesimi ne Open Source

Mbushe formen dhe dergoje ne adresen:

Rrota Interaktive
Kroni i bardhë 60-62, PO Box 263,
10000 Prishtinë, Kosovë

ose

http://register.flossk.org